



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2700/14prot.

Datë 06/02/ 2024

**V E N D I M**

**Nr. 142/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/ 02/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 82/2024 , datë 24.01.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie”, me fond limit 4,981,157.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 13.10.2023, nga autoriteti kontraktor, “Identitek” Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK me NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km.10
- Autoriteti Kontraktor:** “Identitek” Sh.A  
Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Nd.1. Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Librari “Dyrrahu” SHPK me NIPT L91418502J dhe adresë Durrës, Rruga Egnatia/3, Godina 1039, Zona Kadastrale Nr. 8514, Volumi 38, Faqe 125, Numri i Pasurisë 4/162-N1
- .Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni

4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 24.01.2024 , Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.82/2024 , ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie”, me fond limit 4,981,157.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 13.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.
  2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, duke e skualifikuar atë.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing& Distriburion” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 125/35 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2700/11 prot., datë 31.01.2024 , autoriteti kontraktor , Identitek Sh.A. informon se: “Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në autoritet nr.125/25 prot., date 15.11.2023, si dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1202/2023 date 21.11.2023, me kryerien e rivlerësimit të procedurës së prokurimit renditja perfundimtare e OE do të ndryshoie, pasi në zbatim të Vendimeve nuk janë me 2 (dy) OE të kualifikuar, por 3 (tre) OE. Per kete arsye, bazuar në nenin 82 të VKM 285/2021, pika 4, OE "LIBRARI DYRRAHU" DHE OE "MARKETING & DISTRIBUTION" SHPK nuk rezultoi në më me oferte anomalisht të ulet.

Komisioni i Prokurimit Publik në Vendimin nr. 82/2024, nder të tjera ka vendosur:

- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, duke e skualifikuar atë. (për shkak të ofertes anomalisht të ulet). Per sa me sipër, argumentojme se, në zbatim të Vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave drejtuar “Infosoft Office” SHPK nr. 125/25 prot., date 15.11.2023, ku ka vendosur kualifikimin e këtij operatori (“Infosoft Office” SHPK), renditja e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi ka ndryshuar, sepse OE “Infosoft Office” SHPK nga i s’kualifikuar me vlerësimin e KVO-se, ka kaluar i kualifikuar me vendimin e KSHA-se, për këtë arsye bazuar në nenin 82 të VKM 285/2021, pika 4, OE “LIBRARI DYRRAHU” DHE OE “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK nuk rezultoi me oferte anomalisht të ulet në këtë fazë, pasi nga dy

*operator ekonomik të kualifikuar me vendim KVO, ndersa me vendimin e KSHA me kualifikimin e "Infosoft Office" rezultoi 3 OE te kualifikuar”*

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 2632 prot., datë 18.02.2022, protokolluar me tonën nr. 2371/6 prot., datë 19.01.2022, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informon se: *“Me shkresën nr. 125/35 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2700/11 prot., datë 31.01.2024, autoriteti kontraktor Identitek Sh.A. informon se: “Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në autoritet nr.125/25 prot., date 15.11.2023, si dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1202/2023 date 21.11.2023, me kryerien e ri-vlerësimit të procedurës së prokurimit renditja perfundimtare e OE do të ndryshoie, pasi në zbatim të Vendimeve nuk janë me 2 (dy) OE te kualifikuar, por 3 (tre) OE. Per kete arsye, bazuar në nenin 82 të VKM 285/2021, pika 4, OE "LIBRARI DYRRAHU" DHE OE "MARKETING & DISTRIBUTION" SHPK nuk rezultoi në më me oferte anomalisht të ulet.*

*Komisioni i Prokurimit Publik në Vendimin nr. 82/2024, ndër të tjera ka vendosur:*

*2. Autoriteti kontraktor të anuloi vendimin e KVO, për kualifikimin e operatorit ekonomik "Librari Dyrrahu" SHPK, duke e skualifikuar atë. (për shkak të ofertes anomalisht të ulet). Per sa me sipër, argumentojme se, në zbatim të Vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave drejtuar "Infosoft Office" SHPK nr. 125/25 prot., date 15.11.2023, ku ka vendosur kualifikimin e këtij operatori ("Infosoft Office" SHPK), renditja e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi ka ndryshuar, sepse OE "Infosoft Office" SHPK nga i s'kualifikuar me vlerësimin e KVO-se, ka kaluar i kualifikuar me vendimin e KSHA-se, për kete arsye bazuar në nenin 82 të VKM 285/2021, pika 4, OE "LIBRARI DYRRAHU" DHE OE "MARKETING & DISTRIBUTION" SHPK nuk rezultoi me oferte anomalisht të ulet në këtë fazë, pasi nga dy operator ekonomik të kualifikuar me vendim KVO, ndersa me vendimin e KSHA me kualifikimin e "Infosoft Office" rezultoi 3 OE te kualifikuar”*

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim, por nuk ka zbatuar vendimin e Komisionit Prokurimit Publik Nr. 82/2024 datë 24.01.2024 ku në dispozitivin e këtij vendimi pika 2 citohet *“2. Autoriteti kontraktor të anuloi vendimin e KVO, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, duke e skualifikuar atë”.*

Referuar raportit të auditit të kësaj procedure prokurimi operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” vijon të mbetet i kualifikuar.

II.3. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Identitek Sh.A nuk ka zbatuar vendimin Nr. 82/2024 datë 24.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se në rastin konkret, autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për zbatimin e K.P.P 82/2024 datë 24.01.2024, dhe të vërë në dijeni KPP-në për zbatimin e këtij vendimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie”, me fond limit 4,981,157.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 13.10.2023, nga autoriteti kontraktor, “Identitek” Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik K.P.P82/2024 , datë 24.01.2024 për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

